



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 94, Datë 20.04.2018

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË
“SEMAN2SUN” SH.P.K, PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK SEMAN – 2, SHEQ,
MARINAS, FIER ME KAPACITET TË INSTALUAR 2000 KW**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”; neni 5, pika 1 gërma “a”; neni 10, pika 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 109, datë 29.06.2016; neneve 15 dhe 19 pika 1 gërma “a” të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.04.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “SEMAN2SUN” sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Seman-2 Sheq Marinas Fier me kapacitet të instaluar 2000 KW,

Konstatoi se:

- Me shkresën nr. 309 Prot, datë 11.04.2018, shoqëria “SEMAN2SUN” sh.p.k., ka paraqitur kërkesë për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Seman – 2 Sheq Marinas Fier me kapacitet të instaluar 2000 KW.
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me Miratim Përfundimtar, nr. 3888/2, datë 29.12.2017, ka miratuar ndërtimin e burimit të ri gjenerues të energjisë elektrike Fotovoltaike, në zonën Sheq Marinas-Seman, Fier.
- Aplikimi i shoqërisë “SEMAN2SUN” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
 - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “d”) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit tekniko – ekonomik (neni 9, pikat 4.4.1 4.4.2, 4.4.3 (gërmat “a”, “b” “c”, “d”), 4.4.4 (gërmat “a”, “b”, “d”, “e” dhe 4.4.5), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me;

- Nenin 9, pika 3, gërma “c”, (Dokumenta që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj),
- Neni 9 pika 4.4.4, gërmat “c”, (Oponenca teknike e projektit), do të njoftohet subjekti që t’i plotësojë ato brenda afateve që përcakton *“Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”*.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “SEMAN2SUN” sh.p.k, për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Seman – 2 Sheq – Marinas, Fier me kapacitet të instaluar 2000 KW.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI